

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “**BLERJE PAJISJE PËR ZYRAT**”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30190000-7

**VLERA E FONDIT LIMIT: 37.497.780 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, neni 79, pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:*

*c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

*të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

**2.1.2** Për operatorët ekonomik që kanë në objektin e veprimtarisë prodhimin e mobiljeve të drurit, duhet të paraqitet Leja Mjedisore (Autorizim Mjedisor) të lëshuar nga organet kompetente për veprimtarinë në fushën e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** *Duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përvec mallrave edhe transportimin dhe instalimin e disa prej tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të lejes sa më sipër përmendur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

**2.1.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme:

a) Standartin ISO 9001:2015 ose e përditësuar, për sistemin e menaxhimit të cilësisë

b) Standartin ISO 45001 – 2018 (ose ekuivalente/ përditësuar)

c) Standartin ISO 3834-2 ose ekuivalente për menaxhimin e cilësisë në saldim

d) Standartin ISO 14001:2015 ose e përditësuar për sistemin e menaxhimit të mjedisit

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.*

**Argumentimi:** *Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 36 dhe neni 77, neni 79, pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e*

prokurimit.

**ISO 9001** parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si certifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

**ISO 45001** është një standard ndërkombëtar, i cili ndihmon kompanitë të përmbushin detyrimet e tyre ndaj autoriteteve përkatëse në lidhje me garantimin e sigurisë së shëndetit në punë. Ky sistem përqendrohet në kontrollin efektiv të të gjitha rreziqeve në punë duke përfshirë të gjitha palët në proces (punëtorët, vizitorët, siguruesit, shoqëria) si dhe përmirësimin maksimal të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë brenda kompanisë.

Zbatimi dhe certifikimi i Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ndihmon një kompani në:

- Identifikimin dhe menaxhimin e të gjitha rreziqeve të mundshme përmes zbatimit të programeve të zvogëlimit të rreziqeve si dhe minimizimin e rreziqeve në mjedisin e punës;
- Reduktimin e aksidenteve që ndodhin në kompani;
- Përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së kompanisë për çështje që lidhen me shëndetin dhe sigurinë në punë;
- Monitorimin dhe zbatimin sistematik të legjislacionit të shëndetit dhe sigurisë në punë;
- Uljen e kostos nga aksidentet (kompensimin, shtrimin në spital, etj.)

**ISO 14001** specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimin të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;

- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

Standardi ISO 3834-2 përcakton kërkesat e cilësisë për saldimin si në punishte ashtu edhe në vend; - jep udhëzime për përshkrimin e një prodhuesi në lidhje me aftësinë e tij të saldimit, në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 6 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtyre kriterëve, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi nëpërmjet testimit dhe metodave për testim të cilat kanë një rendësi të veçantë për Autoriteti/enti kontraktor.

**2.1.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e analizave dhe testimit të produktit, të lëshuara nga një laborator i certifikuar për të lëshuar certifikatat për cilësinë e produktit, Karrige: *SSH/EN 1335-1:2000/AC:2002*; *SSH/EN 1335-2:2009*; *SSH/EN 1335-3:2009*; ose ekuivalente, Tavolina: *SSH/EN 12521:2015* ose ekuivalente, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40 dhe neni 44, pika 1 “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimi.”. Kërkesa për certifikatat e cilësisë të kërkuara nga autoriteti kontraktor për mallrat të cilat operatori ekonomik do të ofertojë, në mënyrë që të vërtetohet se këto mallra janë prodhuar sipas standarteve dhe kërkesave të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, është në të drejtë të autoritetit kontraktor, i cili në kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkojë dokumentacion provues për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në lidhje me këtë kriter, AK i është referuar një standarti ndërkombëtar, sikurse përcaktohet edhe në nenin 26 “Specifikimet teknike”, të LPP-së,.... standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

## 2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 %** e vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratave, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

***Argumentimi:** Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, ..... "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. "Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër", si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"....."Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;“, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6,*

të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së pritshme të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2** Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 10 (dhjetë) personave, nga të cilët të paktën 1 (një) punonjës duhet të jetë i punësuar si Inxhinier druri i pajisur me diplomë dhe kontratë pune e vlefshme dhe 1 (një) inxhinier mekanik i pajisur me

*diplomë dhe kontratë pune e vlefshme.*

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilitin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për tre muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B.
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore (e-Sig02/a) ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e tre muajve të fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B.

*\*Plotësimi i kësaj kërkesë do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Deklaratës Përmbledhëse të Vetëdeklarimit, Shtojca 8, në të cilën të përcaktojnë të dhëna të sakta sipas kërkesave të kësaj pike me qëllim që autoriteti të bëjë mundur ballafaqimin e tyre në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik.*

**Argumentimi:** *Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

*Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve. Duke marrë shkas nga fakti që tipi i kontratës është blerje mallra, dhe me anë të kësaj kontrate kërkohet furnizimi dhe vendosja e tyre, kriteri i AK në lidhje me fuqinë punëtore të nevojshme për zbatimin e kontratës, është hartuar duke vlerësuar nevojën për fuqinë punëtore të nevojshme për transportin dhe montimin e këtyre mallrave.*

*Objekti i procedurës së prokurimit “Blerje pajisje për zyrat” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të mobiljeve pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e pajisjeve mobilje për institucionin e Bashkisë Tiranë. Specialistët i kërkuar janë të nevojshëm për të asistuar stafin e AK që do të ketë për detyrë procesin e prodhimit apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi. Duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përveç mallrave edhe transportimin dhe instalimin e disa prej tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të një stafi të konsiderueshëm për realizimin në kohën e duhur të*

*lëvrimit dhe instalimit të tyre pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë*

*Procedura e prokurimit në fjalë, referuar specifikimeve teknike, është lehtësisht e kuptueshme që artikujt objekt prokurimi nuk janë artikuj që gjenden në subjekte tregtare të tilla si pika shitje pasi kanë përmasa dhe specifika të ndryshme referuese dhe duhet të përshtaten me vendet ku do të vendosen/ montohen, pra do duhet të merret serish përmasat dhe të prodhohen në mënyrë që të përshtaten me kërkesat e AK. Për sa më sipër, AK nuk është në gjendje të identifikojë pra nuk ka në staf ekspert të fushës inxhinierë druri për të mundësuar njohjen e saktë të materialit të produktit që do të ofrohet, si dhe ndjekjen hap pas hapi të procesit të prodhimit të tyre konform specifikimeve teknike.*

*Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.*

*Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti mallrash, me peshë ngarkese transporti të paktën 1 ton. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

Në rastet kur mjeti është në pronësi: *Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS); taksa vjetore.*

Në rastet kur mjeti është me qera: *Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi; Certifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi; siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit); çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS); taksa vjetore.*

*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B, në të cilën të përcaktojnë të dhëna të sakta sipas kërkesave të kësaj pike me qëllim që autoriteti të bëjë mundur ballafaqimin e tyre në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik.*

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion*



mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*Mjetet e mësipërm janë të domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj I shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. **Duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përvec mallrave edhe transportimin dhe instalimin e disa prej tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të mjeteve të nevojshme për realizimin në kohën e duhur të lëvrim të tyre pranë ambjenteteve të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë.***

*Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e autoriteteve kontraktore, të përfshira në këtë procedurë prokurimi.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë ambjente prodhimi ose magazinimi, me sipërfaqe të paktën 500 m<sup>2</sup>. Për këtë operatori duhet të paraqesë çertifikate pronësie ose kontratë qeraje të ambientit. Në rast të disponimit të ambientit nëpërmjet qerasë duhet të paraqitet edhe certifikata e pronësisë së qeradhënësit.

*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B, në të cilën të përcaktojë të dhëna të sakta sipas kërkesave të kësaj pike me qëllim që autoriteti të bëjë mundur ballafaqimin e tyre në momentin e dorëzimit të dokumentacionit fizik.*

**Argumentimi:** Referuar sasisë dhe përmasave të artikujve objekt prokurimi, AK Bashkia Tiranë nuk ka ambjente ruajtje dhe magazinimi të mjaftueshme por as të përshtatshme ku të mund të mbajë një sasi mobiljesh të cilat do të vendosen/ montohen jo brenda një dite por sipas kërkesave të AK. Për këtë arsye, AK ka kërkuar që kjo të mundësohet nga OE fitues i cili do të realizojë prodhimin e mobiljeve brenda afatit të kërkuar referuar afatit të ekzekutimit të kontratës së përcaktuar nga AK në DST dhe do të mbajë ato të magazinuar duke i lëvruar ato sipas kërkesave të AK sipas rastit.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 1 vjecare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

**2.3.7** Operatori ekonomik në lidhje me artikujt objekt prokurimi dhe/ose lëndët e para të prodhimit

të artikujve objekt prokurimi të përcaktuar në Formularin e sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, që do të paraqesë, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të lëshuara nga një organ i akredituar.

Nr.	Emërtimi i produktit/Lëndës së parë	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			
Etj.,			

**2.3.8** Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë / broshura / foto ilustruese ose cdo lloj dokumentacioni tjetër teknik**, ku të paraqiten specifikimet teknike të secilit artikull që oferton.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra (një copë) sipas specifikimeve teknike të dhënë në DST të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë AK (Drejtoria e Prokurimeve), si më poshtë:

Karriqe rrotulluese

Karriqe pune

Etazher për zyrë

Tavolinë pune me kasatierë

*\*Mosparaqitja e mostrave ditën dhe orën e hapjes së ofertave është kusht për s'kualifikim.*

**Argumentimi për pikat 2.3.6; 2.3.7; 2.3.8:** Këto kërkesa janë vendosur sipas përcaktimeve të bëra në mbështetje të nenit 77 pika 1 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe **aftësitë teknike** e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, si dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

*Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor (grupi i punës), për pajisjet që propozon/oferton.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

### **Specifikimi i parametrave teknik, materialeve etj:**

*Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bazuar në nevojën që AK ka për krijimin e kushteteve të përshtatshme pune për punjonjësit e saj. Në specifikimet teknike të secilit prej artikujve përkufizohen karakteristikat e produktit dhe mënyrës së prodhimit të tyre, siç janë niveli i cilësisë, përshkrim i të gjitha kushteve që duhet të plotësojë produkti i prodhuar, duke përfshirë edhe vlerësim të përputhshmërisë së lëndës së parë të përdorur dhe produktit final, forma dhe përmbajtja, niveli i sigurisë dhe dimensione, përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, llojet e materialit, ngjyrës, garancisë së produktit, përmasat etj procese dhe metodat të domosdoshme për prodhimin e tyre në secilën fazë, në mënyrë që operatorët ekonomikë të interesuar, të kenë informacion të plotë mbi prodhimin e produktit dhe të kenë mundësi të përmbushin kushtet e kriteret sipas specifikimeve të hartuara nga AK.*

*Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka si detyrë funksionale, plotësimin e të gjitha kërkesave dhe nevojave pjesë të aparatit të institucionit. Gjithashtu Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse për furnizimin me pajisje për mobilimin e zyrave dhe për njësitë bashkiake dhe lagjet e reja, të cilat janë shumë të nevojshme dhe duhet të jenë sa më cilësore sipas specifikimeve teknike për krijimin e kushteve sa më të mira të punës.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje pajisje për zyrat”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**